



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**

---

Raport nga takimi mbi Strategjitë për ri-licencimin  
dhe digjitalizimin

Korrik 2008

## Përmbajtja

Hyrje .....	3
Licencimi .....	4
Procesi i ri-licencimit dhe sfidat .....	4
Historiku i zhvillimit të rregullatorit dhe gjendja aktuale në Kosovë.....	4
Strategjia për ri-licencim – opcionet .....	6
Objektivat e procesit dhe veprimet e nevojshme .....	9
Konkluzionet mbi procesin e licencimit .....	11
Digjitalizimi.....	13
Roli i ITU-së dhe Rregullatorit në planifikimin e frekuencave digjitale – Stanko Perpar .	13
Perspektiva dhe përvoja e Maqedonisë – Zoran Stefanovski.....	15
Perspektiva dhe përvoja e Sllovenisë – Stanko Perpar .....	16
Perspektiva dhe përvoja e Shqipërisë – Elton Poga .....	17
Procesi i digjitalizimit në Kosovë .....	18
Objektivat e procesit të digjitalizimit dhe veprimet e nevojshme .....	19
Konkluzionet nga seanca e digjitalizimit.....	20
Përmbledhje ekzekutive .....	21
Aneksi 1 – Agjenda e takimit .....	24
Aneksi 2 - Lista e pjesëmarrësve .....	

## Hyrje

Ky raport paraqet diskutimet dhe konkluzat nga takimi i parë i Këshillit e Stafit të KPM-së dhe ekspertëve mbi proceset e ri-licencimit dhe digjitalizimit të sektorit medial në Kosovë. Takimi, i pari i këtij lloji i organizuar nga KPM, u mbajt në Shkup më datat 21-24 korrik 2008 dhe përfshiu një grup të gjerë pjesëmarrësish nga KPM-ja si dhe hisenikët e tjerë nga sektori mediatik. Diskutimi mbi strategjitë e këtyre proceseve ishte i ndarë në dy pjesë.

Pjesa e parë kishte për fokus procesin e ri-licencimit, gjegjësisht dhënies së licencave afatgjate për mediat Kosovare. Seanca filloi me prezentimin e situatës momentale të ambientit rregullativ të mediave në Kosovë. Më pas, përfaqësuesit e KPM-së paraqitën skenare të mundshme për procesin e ri-licencimit si dhe përparësitë dhe mangësitë e këtyre skenareve. U prezentua poashtu edhe situata momentale e frekuencave të cilat përdoren për transmetim nga mediat Kosovare si dhe standardet ndërkombëtare të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU), të cilat rregullojnë alokimin e këtyre frekuencave. Pas prezantimeve u paraqitën idetë e ndryshme për qasjen ndaj këtij procesi, i cili u ri-emërua në procesin e licencimit afatgjatë të mediave. Gjatë diskutimeve u arrit pajtueshmëria e pjesëmarrësve rreth principeve të këtij procesi, objektivat e procesit si dhe veprimet që KPM duhet të ndërmarrë për realizimin e tij.

Pjesa e dytë e takimit u fokusua në procesin e digjitalizimit të transmetimit medial në Kosovë. Për këtë diskutim, takimit iu bashkangjitën edhe përfaqësues të mediave Kosovare, transmetuesve që këto media shfrytëzojnë, përfaqësues të IREX-it si organizatë përkrahëse e mediave Kosoavre si dhe një numër ekspertësh të cilët ndanë me grupin përvojat e tyre nga ky proces. Tre prezentues nga Sllovenia, Maqedonia dhe Shqipëria paraqitën përvojat dhe proceset e digjitalizimit të ndjekura në vendet e tyre. Poashtu, eksperti Slloven paraqiti edhe përvojën e tij rreth punës së ITU-së dhe pozitës së Kosovës ndaj këtij trupi. Pjesëmarrësit e takimit filluan diskutimet për hapat e parë që Kosova duhet të ndërmarrë për të filluar procesin e gjatë të digjitalizimit, drejt të cilit nuk është ndërmarrë asnjë hap. Në fund u arrit pajtueshmëria për hapat e parë që KPM duhet të ndërmerr në këtë drejtim.

## Licencimi

### Procesi i ri-licencimit dhe sfidat

Takimi filloi me mirëseardhjen e paraqitur nga Kryesuesja e Këshillit të KPM-së, znj. Grazhdani. Ajo theksoi se procesi i ri-licencimit është një proces i rëndësishëm shumë të madhe dhe e cilësoi këtë proces si një nga sfidat më të mëdha të KPM-së. Qëllimi i këtij procesi duhet të jetë që të arrihet një strategji e kuptimtë por e thjeshtë që do të ishte në interes të përgjithshëm shoqëror, e që do të mund t'i prezentohej publikut. Si sfida tjetër në këtë proces është puna voluminoze që duhet të kryhet nga KPM-ja. Në këtë proces, sipas znj. Grazhdani presionet vijnë nga dy anë. Njëra nga ata të cilët konsiderojnë që i tërë tregu është në kaos dhe duhet të rregullohet dhe tjetra që tregu rregullon vehten dhe nuk duhet shumë përzierje. KPM duhet të punojë në interesin e përgjithshëm shoqëror dhe ky duhet të jetë udhërrëfytes për KPM-në në këtë proces.

### Historiku i zhvillimit të rregullatorit dhe gjendja aktuale në Kosovë

Znj. Naile Selimaj-Krasniqi, drejtoreshë ekzekutive e zyrës së KPM-së, paraqiti një prezentim mbi gjendjen aktuale në fushën rregullative të mediave në Kosovë. Sipas saj, fillimisht ka ekzistuar një kaos mediatik të cilin organizatat ndërkombëtare në Kosovë kanë tentuar ta rregullojnë. Fillimisht në Kosovë është përdorur modeli i Bosnjës për licencim. Në vitin 2000 u krijua edhe zyra e rregullatorit dhe kishte përmirësim në këtë fushë. Gjatë tre viteve të ardhshme janë mbajtur disa runde licencimi për mediat Kosovare, të cilave iu lëshoheshin licenca të përkohshme. Forma e licencimit ka qenë garuese, ku konkurentët kanë garuar për një frekuencë. Një problem me këtë ka qenë se Panelet për Licencim kanë vendosur kriteret e veta për licencim në secilën rundë ashtu që kriteret e përdorura për licencim nuk kanë qenë standarde. Në këtë mënyrë licencat e përkohshme janë lëshuar deri në vitin 2006 kur edhe është bërë transferimi i përgjegjësisë nga komisioneri ndërkombëtar i mediave tek Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM). KPM në vitin 2006 vendosi të mos lëshojë më licenca në mënyrë që të konsolidohet tregu para se të fillojë të lëshojë licenca afatgjate.

Për momentin në Kosovë kemi 113 media të licencuara, prej tyre 20 TV stacione dhe 93 radio stacione, të kategorizuara në subjekte transmetuese kombëtare, teknikisht regjionale, lokale dhe me fuqi të ulët. Brezi frekuencor është shumë i ngarkuar dhe jo në harmoni me planin frekuencor të Kosovës si dhe atë të ITU-së. Poashtu janë identifikuar mjaft probleme me interferenca.

Puna e KPM-së është e mbuluar nga Ligji mbi KPM-në, i cili jep edhe mbështetjen më të fortë për KPM-në. KPM-ja është e autorizuar nga ligji të nxjerr legjislacion sekondar mbi aktivitetin rregullativ të mediave. Sipas znj. Selimaj-Krasniqi sfidat për KPM-në janë

procesi i licencimit afatgjatë dhe digjitalizimit, prezentimi i KPM-së para publikut Kosovar dhe mundësitë logjistike për të përdorur të gjithat pikat e transmetimit në Kosovë, përfshirë edhe Goleshin.

Mbi situatën aktuale në brezin frekuencor, z. Besim Govori, udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Frekuencave, prezantoi punën dhe analizat e KPM-së. Z. Govori prezantoi matjet e bëra nga ky Divizion në kuadër të KPM-së dhe konkluzat nga këto matje. Këto matje ishin të bëra përmes programit të ICS Telecom dhe kanë analizuar transmetimet analoge. Z. Govori poashtu prezantoi edhe situatën mbi rregullimin ndërkombëtar të transmetimeve analoge (sipas Stockholm 61) dhe digjitale (sipas Geneva 06).

Sipas planit të Stokholmit, është përcaktuar shpërndarja e frekuencave për shërbime TV në VHF dhe UHF për Kosovën në kuadër të planifikimit radiodifuziv analog për Evropën. Me këtë plan, për Kosovën ishin paraparë të ndërtohen 4 rrjeta të nivelit kombëtar, kurse sa i përket TV lokale-komunale apo komerciale, ITU nuk e ka paraparë këtë lloj shërbimi në atë kohë. Sa i përket shpërndarjes së frekuencave në brezin FM/VHF për Kosovën, kjo përcaktohet me Planin ITU Gjeneva 84. Ky plan përmban katër rrjeta radio në nivel Kombëtar dhe rrjetat plotësuese në nivel lokal.

Pas luftës në Kosovë, menaxhimi i brezit frekuencor radiodifuziv është bërë nga KFOR-i – J6, ndërsa në vitin 2000, menaxhimi i këtij brezi bartet te OSBE-ja, gjegjësisht Komisioneri i Përkohshëm për Media. Po në këtë vit KPM në bashkëpunim me ekspert nga Anglia, modifikuan planin frekuencor të Kosovës për TV dhe FM duke marrë si bazë planin frekuencor të ITU Stokholm 61 dhe Gjeneva 84. Sipas z. Govori ky modifikim është bërë pa pasur një strategji të mirëfilltë të zhvillimit radiodifuziv në Kosovë gjë që ka shkaktuar problem për një planifikim të mirëfilltë të Planit Frekuencor të Kosovës.

Sipas z. Govori, aktualisht brezi frekuencor radiodifuziv në Kosovë është i ngarkuar për shkak të një numri të madh të frekuencave lokale dhe atyre për nevoja të KFOR-it, të cilat janë dhënë pa ndonjë strategji për zhvillimin e radiodifuzionit në Kosovë. Numri i kufizuar i kanaleve TV në brezin VHF dhe UHF prej 59 kanalesh përcaktohet nga rekomandimet ndërkombëtare për planifikimin e rrjetave tokësore televizive, dhe nënkupton se duhet të bëhet shfrytëzim racional i brezit frekuencor për shkak të numrit të limituar të kanaleve.

Dhënia e frekuencave në përdorim është proces i ndërlikuar dhe me përgjegjësi për autoritetin rregullator, pasi përveç respektimit të standardeve e kushteve teknike të transmetimit për mbulimin e territoreve të caktuara, për çdo frekuencë që jepet në përdorim bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare duhet të kryhet koordinimi me të gjitha vendet fqinje, brenda distancës së koordinimit e përcaktuar nga dokumentet e adaptuara në konferencat ndërkombëtare. Sipas z. Govori, kjo do të jetë një nga sfidat më të mëdha për KPM-në gjatë procesit të licencimit afatgjatë.

z. Govori theksoi se është shumë e rëndësishme që pika transmtuese në Golesh të aktivizohet për përdorim të transmetimeve televizive lokale. Kjo pikë, për momentin është nën kontroll ekskluziv të KFOR-it është e paraparë sipas të gjitha planeve ndërkombëtare si pikë transmetimi në Kosovë dhe këto plane na obligojnë ta aktivizojmë këtë pikë. Përmes aktivizimit të pikës së Goleshit, sipas z. Govori, lirohen kapacitetet e shumë transmetuesve lokalë të cilët mund të përdoren për transmetime lokale dhe regjionale.

Duke komentuar rreth kësaj çështjeje, znj. Grazhdani theksoi se është me rëndësi që të shiqohet nëse mund të arrihet marrëveshje me KFOR-in pasi që kjo do të ndikonte edhe procesin e licencimit afatgjatë.

Znj. Grazhdani kërkoi nga Divizioni për Menaxhimin Frekuencor që të përgatisë një plan frekuencor me Goleshin si pikë transmetuese dhe një plan duke mos llogaritur Goleshin. Po ashtu ajo kërkoi që në planet e zyres së KPM-së të përfshihet edhe analiza se cilat janë frekuencat problematike dhe cilat janë ato që rekomandohen. Ky plan duhet të përfshij edhe pikat transmetuese nga lartësitë mbidetare të lejuara sipas standardeve.

### **Strategjia për ri-licencim – opsionet**

Seanca mbi diskutimin e seknareve të mundshme për procesin e ri-licencimit filloi me prezentimin e disa opsioneve nga znj. Selimaj-Krasniqi. Pas saj, propozimin e saj e prezantoi edhe znj. Samra Campara nga OSBE-ja. Seanca vazhdoi me diskutime rreth opsioneve të mundshme për këtë proces.

Znj. Selimaj-Krasniqi ceku se KPM ka marrë shumë kërkesa për licencime nga mediat e ndryshme, mirëpo nuk ka lëshuar licenca të reja në mënyrë që të standardizojë punën e saj dhe të fillojë rishtazi procesin e licencimit afatgjatë të mediave Kosovare. Prosesi i licencimit është shumë i rëndësishëm, është obligim ligjor, i cili do të mundësonte zhvillimin e mëtutjeshëm të zhvillimit të sektorit mediatik në Kosovë. Sipas znj. Krasniqi ekzistojnë dy mundësi për zhvillimin e këtij procesi, ritenderimi i frekuencave apo vazhdimi i licencave për transmetuesit aktual.

Mënyra e parë, përmes ri-tenderimit të të gjitha frekuencave, do të ishte një ngarkesë e madhe për KPM-në dhe nuk do të kishte rezultate të garantuara. Në një skenar të tillë do të hapeshte konkursi për mbi 100 licenca, përveç për transmetuesin publik. Një qasje e tillë do të krijonte një situatë kaotike dhe të pasigurtë. Kjo do të vononte procesin dhe do ta shtynte atë për një kohë të gjatë, ndërkohë që KPM-ja duhet të përfundojë me këtë proces dhe të fokusohet gjithnjë e më shumë në procesin e digjitalizimit. Kjo metodë, sipas znj. Selimaj-Krasniqi, do të vinte në rrezik rezultatet e arritura deri tani dhe do të shkaktonte probleme në zhvillimin e planeve të KPM-së.

Mënyra e dytë, përmes vazhdimit të licencave për transmetuesit ekzistues, do të ishte metodë më e shpejtë. Kusht për vazhdimin e licencave do të ishin kriteret e reja të

caktuara nga KPM, të cilat do të siguronin që mediat që marrin licenca afatgjate të jenë të qëndrueshme, me programacion në të mirë të publikut, të respektojnë të drejtat autoriale dhe të plotësojnë standardet teknike të transmetimit. Mediat duhet të ofrojnë raportet e tyre financiare, gjë që është edhe kërkesë ligjore. Poashtu, sipas znj. Selimaj-Krasniqi, KPM-ja duhet të kryej obligimin ndaj mediave ashtu që të ofrojë një proces të paanshëm që do të mundësonte zhvillimin e papenguar të tyre. KPM-ja duhet të punojë në përgaditjen e dokumenteve për aplikim dhe të caktohet plani frekuencor që duhet të ndjeket. E gjithë kjo punë duhet të bëhet në bashkëpunim me të gjitha palët me interes dhe përmes një procesi publik.

Sipas znj. Selimaj-Krasniqi, rekomandimi i zyrës së KPM-së është që të aplikohet metoda e dytë, e cila nuk është zgjidhje e përkryer por është më e mira e mundshme.

Pas prezentimit nga zyra e KPM-së, znj. Samra Campara nga OSBE-ja, prezantoi propozimin e saj për procesin e ri-licencimit. Sipas saj, fokusi i këtij procesi duhet të jetë anëtarësimi i Kosovës në ITU në stad afatgjatë. Në mënyrë që të arrihet kjo, znj. Campara propozon që të ndërmerren hapat në vijim. Së pari, vendi duhet të ndahet në pesë apo më shumë regjione. Për këto regjione pastaj duhet të hapen konkurse për mediat për alokimin e frekuencave. Përfundimisht, frekuencat duhet të alokohen në bazë të kategorive në të cilat klasifikohen mediat. Për këtë proces, sipas znj. Campara, duhet të caktohen kriteret për vlerësim të aplikimeve ku do të caktoheshin pikë të caktuara për kualitetin e programit, raportet financiare, aftësinë teknike, dhe përputhshmërinë me rregulloret e KPM-së. Për të realizuar këtë, sipas znj. Campara, duhet të përgaditen një varg dokumentesh si kodi i mirësjelljes, procesi i konkurrencës, të caktohen nivelet e pagesës, etj. Znj. Campara ofroi ndihmën e zyrës së OSBE-së lidhur me hartimin e rregullave dhe normave dhe në këtë proces mund edhe të kërkojmë ndihmën e kolegëve nga rajoni. Poashtu duhet të kemi parasysh edhe afatet kohore ashtu që procesi të fillojë sa më parë. Një proces i tillë sipas znj. Campara është ndjekur edhe në Bosnjë e Hercegovinë, dhe edhe pse ky proces nuk ka qenë ndonjë mrekulli, ka zgjidhur shumë probleme.

Anëtarë i Këshillit të KPM-së, z. Karol Jakubowicz, ofroi propozimin e tij mbi këtë proces. Ai së pari theksoi se nuk kemi nevojë për një proces të ri-licencimit. Ai theksoi nevojën e gjetjes së një termi më të përshtatshëm, më neutral, në mënyrë që të zbuten brengat e mediave ekzistuese. KPM, sipas tij, duhet të punojë duke pasur parasysh dy këndvështrime, të rregullatorit dhe të transmetuesve. Një term që do të merrte parasysh të dy këto këndvështrime sipas z. Jakubowicz është “Normalizimi i tregut transmetues”.

Z. Jakubowicz paraqiti tre skenare të mundshme për të ndjekur procesin. I pari, i cili do të sfidonte të gjithë sistem rregullator, duke nisur një proces të rilicencimit përmes ritenderimit të frekuencave. Një proces i tillë do të shkaktonte më së shumti kokëçarje për KPM-në dhe transmetuesit dhe nuk do të garantonte suksesin e procesit. Skenari tjetër ekstrem është ai i riemërimit të të gjitha licencave nga të përkohshme në të

përhershme, gjë që poashtu nuk do të bënte asgjë në drejtim të rregullimit të tregut. Skenari i tretë, i cili edhe ishte më i preferuari për z. Jakubowicz, është ai i një qasjeje të kombinuar ku transmetuesit aktual do të ndaheshin në tre grupe, ata të mirë, transmetuesit me probleme dhe transmetuesit e kqinj.

Sipas skenarit të kombinuar, transmetuesve të mirë, të cilët nuk kanë pasur asnjë problem administrativ me KPM-në, duhet t'ju ofrohet mundësia e shëndërrimit të licencës së përkohshme në afatgjate në mënyrë automatike vetëm përmes një kërkesë nga ana e vet transmetuesit ku kërkohet një gjë e tillë, sepse nuk mund të paragjykojmë nëse transmetuesit aktual dëshirojnë të vazhdojnë me veprimtarinë e tyre ashtu që edhe për licencimin automatik duhet të paraqitet një kërkesë nga vetë transmetuesi. Për transmetuesit me probleme, KPM-ja do të duhej të cakton kushte të cilat këta transmetues duhet t'i plotsojnë për të marrë licencën afatgjate. Së fundi, për transmetuesit e kqinj, KPM-ja mund të ndjekë procesin e ritenderimit të frekuencës dhe t'i vejë këto media në garë me konkurrentë tjerë. Poashtu, sipas z. Jakubowicz, KPM-ja duhet të ofrojë mundësinë për lëshimin e licencave për transmetuesit e rinj në treg. Një proces i tillë, sipas z. Jakubowicz, do të ishte më i lehtë, dhe përmes një qasjeje të disintegruar do të arrinte të shtynte procesin përpara pa i komprometuar standardet e synuara. Në fund, z. Jakubowicz kërkoi nga zyra ligjore në kuadër të KPM-së të shiqojë ligjshmërinë e një qasjeje të tillë. Sipas tij, kriteri i vetëm që duhet të marrim parasysh është përputhshmëria me ligjin. Po që se kemi fakte që një transmetues ka thyer ligjin dhe nuk i janë përmbajtur kushteve të licencës së përkohshme, atëherë ne duhet të klasifikojmë këtë transmetues si problematik.

Pas prezenteve të paraqitura znj. Grazhdani falenderoi prezentuesit. Ajo theksoi se rilicencimi është një term që po i frikëson mediat që kanë licencë. Në përgjigje ndaj propozimit të z. Jakubowicz, znj. Grazhdani u shpreh se pajtohet plotësisht me propozimin. Sipas saj, nuk është e mundur që të rishiqohet secila licencë, ashtu që një proces i tillë i disagreguar është më i qëlluari. Një proces i tillë lejon KPM-në të fillojë me procesin e licencimit afatgjatë për transmetuesit e mirë, ndërsa për ata me probleme mund të ketë afate të ndryshme kohore.

Diskutimi vazhdoi me çështjen e ngritur nga znj. Grazhdani, se çka do të thotë ky proces dhe cilat janë problemet që ne dëshirojmë t'i zgjidhim me këtë proces. Disa nga këto probleme janë të natyrës teknike, disa me të drejtën e autorit, e disa të natyrës menaxheriale mbi menaxhimin e kërjës procesi dhe përcaktimin e afateve kohore. Sipas saj, KPM poashtu duhet të ketë parasysh çështjen e një mediumi kombëtar në gjuhët e pakicave, i cili parashihet edhe nga plani i Ahtisarit.

Pas diskutimeve u arrit pajtueshmëria në princip e të gjithë pjesëmarrësve për modelin e propozuar nga z. Jakubowicz. Sipas anëtarëve të Këshillit të KPM-së, procesi i kategorizimit mund të bëhet dhe ekzistojnë kriteret e qarta ligjore të cilat duhen



respektuar nga transmetuesit dhe se në bazë të respektimit të tyre në të kaluarën mund të bëhet klasifikimi.

Disa komente nga pjesëmarrësit u fokusuan në emërtimin e procesit si Normalizim. Si i tillë, ky term u konsiderua si i zbehtë, prandaj pjesëmarrësit u morrën vesh që ky proces të emërtohet: **“Licencimi afatgjatë i mediave në Kosovë”**.

## **Objektivat e procesit dhe veprimet e nevojshme**

Pasi që pjesëmarrësit u pajtuan rreth emërimit *“Licencimi afatgjatë i mediave në Kosovë”* për procesin që KPM duhet të ndjekë. Në bazë të diskutimeve të grupit u vendos që objektiv i përgjithshëm i procesit të jetë *“Normalizimi i ambientit rregullativ mediatik në Kosovë”*.

Diskutimi pastaj u fokusua në përcaktimin e principeve që do të udhëheqin procesin e licencimit afatgjatë të mediave në Kosovë. Principet për të cilat u arrit pajtueshmëri janë të paraqitura në vijim:

- Procesi duhet të jetë në përputhshmëri me planin frekuencor të Kosovës
- Procesi duhet të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të sektorit medial në Kosovë
- Procesi duhet të krijojë mundësi për përmbushjen e nevojave të të gjitha komuniteteve për qasje në media në gjuhën e tyre
- Procesi duhet të kontribuojë në zbatimin e politikave të transmetimit të përcaktuara në Ligjin mbi KPM-në

Qasja e përbashkët e të gjithë pjesëmarrësve ishte se ky proces duhet të jetë miqësor për transmetuesit dhe që ata të ndihen rehat me te.

Si rezultat i diskutimeve rreth skenareve të mundshme për procesin e licencimit afatgjatë dhe metodës së zgjedhur, u përcaktuan objektivat e procesit të licencimit afatgjatë si vijon:

**Objektivi 1:** Lëshimi i licencave afatgjate për mediat përmes klasifikimit të transmetuesve në tre kategori (automatikisht, me kushte, ritenderim) në bazë të përputhjes me legjislacionin dhe kushtet e kontratave të përkohshme (varet nga ligjshmëria!) si dhe lëshimi i licencave afatgjate për transmetuesit e rinj.

**Objektivi 2:** Përcaktimi i kriterëve (kërkesave) të njëjta për të gjitha mediat, duke përfshi kriteret në vijim: Teknike; të drejtat autoriale; financiare (qëndrueshmëria financiare); programore dhe qartësimi i pronësisë dhe strukturave menaxhuese.

**Objektivi 3:** Standardizimi i procedurave dhe dokumentacionit për licencim.

**Objektivi 4:** Krijimi i planit për distribuimin e frekuencave (përfshirë edhe periudhën pas digjitalizimit) dhe përcaktimi i pikave transmetuese.

**Objektivi 5:** Krijimi i mundësisë për një transmetues publik kombëtar në gjuhët e pakicave

Si pjesë e diskutimeve rreth objektivave u ngritën edhe katër çështje. E para ishte e ndërlidhur me procesin e digjitalizimit dhe se si ky proces ndërlidhet me procesin e licencimit afatgjatë. Në bazë të diskutimeve u arrit pajtueshmëria se edhe pse digjitalizimi si proces do të pasojë licencimin afatgjatë, licencat afatgjate të lëshuara nga KPM-ja duhet të theksojnë se vlejné vetëm deri në kalimin në transmetim digjital. Kjo për shkak të mundësive të reja teknologjike që ofrohen nga digjitalizimi për shfrytëzimin e brezit frekuencor. Vlefshmëria e kufizuar e licencës deri në digjitalizim duhet të theksohet në mënyrë të veçantë në kushtet e licencës. Çështja e dytë që u ngrit ishte mbarëvajtja e procesit me transmetuesit në gjuhën sërbe. Zyra e KPM-së informoi të pranishmit që bashkëpunimi i këtyre medimeve me KPM-në deri tani ka qenë i mirë dhe mund të supozojmë se një bashkëpunim i tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen, sidomos pasi kjo është edhe në interesin e tyre. Çështja e tretë ka të bëjë me hapjen e tregut mediatik Kosovar përmes procesit të licencimit afatgjatë. Ekziston frika në mediat Kosovare nga depërtimi dhe marrja e tregut nga mediat e huaja. Ky është sidomos një rrezik për mediat me transmetim lokal. Pasi që nuk ekziston një bazë ligjore për të ndaluar investimet e huaja në këtë sektor, atëherë mbrojtja më e mirë, sipas pjesëmarrësve, është fuqizimi i mediave Kosovare. Një propozim për këtë fuqizim është edhe ofrimi i mundësisë për zgjerimin e hapsirës transmetuese të mediave që dëshirojnë këtë. Çështja e fundit ishte ajo rreth ofrimi të mundësisë për mbulim kombëtar me një transmetim në gjuhët e minoriteteve. Pas diskutimeve u vendos që divizioni për menaxhimin e frekuencave të shiqojë mundësitë teknike për të ofruar rrjetin e katërt të transmetuesve kombëtar, në gjuhët e pakicave.

Çështja e planit frekuencor ndërlidhet me tre aspekte. Së pari, mangësitë paraqiten për shkak të pamundësisë së përdorimit të dy pikave të larta transmetuese, ato të Goleshit dhe Cvilenit, të cilat për momentin shfrytëzohen dhe kontrollohen plotësisht nga KFOR-i. Nga Këshilli i KPM-së u kërkua që Divizioni për Menaxhimin Frekuencor të sajojë dy plane, njërin i cili përfshin Goleshin dhe Cvilenin dhe tjetri pa këto pika. Poashtu u diskutua edhe çështja e frekuencave problematike sa i përket interferencave dhe transmetimeve që kalojnë hapsirën e lejuar për transmetim dhe u kërkua nga ky divizion të sajojë një raport mbi këto. Së fundi u diskutua edhe çështja e digjitalizimit dhe ndikimit të këtij procesi në brezin e disponueshëm frekuencor dhe në planin frekuencor të KPM-së.

Diskutimi pastaj u fokusua në veprimet që KPM duhet të ndërmer në procesin e licencimit afatgjatë, përcaktimin e afateve kohore për këtë proces dhe përcaktimin e personave përgjegjës. Në bazë të objektivave të përcaktuara dhe paraqitura më lartë,

pjesëmarrësit punuan edhe një Plan Pune për KPM-në në mënyre që të realizohen objektivat dhe të arrihet qëllimi i këtij procesi.

Pjesëmarrësit u pajtuan për planin e veprimit si vijon:

VEPRIMI	AFATI KOHOR	PËRGJEGJËSI
1. Kriteret për kategorizimin e mediave	15 gusht 2008	KPM
2. Krijimi i profileve për mediat aktuale	30 tetor 2008	KPM
3. Përcaktimi i kriterëve për licencim	15 nëntor 2008	KPM
4. Plani i distribuimit të frekuencave	30 tetor 2008	KPM
5. Standardizimi i dokumentacionit dhe procedurave	30 dhjetor 2008	KPM
6. Shpallja e konkursit (njoftimi)	15 shkurt 2009	KPM
7. Shqyrtimi i aplikacioneve dhe lëshimi i licencave	Grupi 1 (automatikisht) – 30 mars 2009	KPM
	Grupi 2 (me kusht) – 30 qershor 2009	
	Grupi 3 (ritenderim) – 31 dhjetor 2009	

### Konkluzionet mbi procesin e licencimit

Konkluzionet kryesore nga seanca mbi procesin e licencimit afatgjatë të mediave në Kosovë kishin të bëjnë me metodologjinë që duhet përdorur, principet që do të udhëheqin këtë proces, objektivat që duhen arritur dhe planin e veprimit për t'i arritur këto objektiva.

Gjatë diskutimit u vendos që të ndjeket një proces i përzier, ku transmetuesit aktual do të profiloheshin në tre kategori dhe në bazë të tyre të ofrohet vazhdim i menjëhershëm i licencave , ofrimi i licencave me kusht dhe ritenderimi i frekuencës.

Për të gjitha mediat duhet të vlejnjë të njejtat standarde si dhe dokumentet dhe procesi që duhet ndjekur duhet të jetë i hapur për të gjithë. Duhet poashtu të caktohet plani i distribuimit frekuencor. Në bazë të kësaj pune, mediat pastaj do të aplikojnë për licencën afatgjate dhe në bazë të kategorizimit të mediave, plotësimit të kriterëve dhe pajtueshmërisë me planin frekuencor të Kosovës. Prosesi deri në një shkallë do të jetë pothuajse i njejtë për të gjitha mediat, mirëpo arritja e qëllimeve specifike për secilën kategori të transmentuesve do të jetë e ndarë në tre faza. Transmetuesit me automatizëm do të marrin licencë më së largu në fund të marsit. Në qershor te vitit 2009 planifikohet të merret vendim rreth transmetuesve problematik. Dhe së fundi, për një

KPM – Raport nga takimi mbi Strategjitë mbi ri-licencimin dhe digjitalizimin

kohë të gjatë, KPM-ja do të shyrtoj rastet për ritnederim dhe do të kryej edhe këtë element të fundit në procesin e licencimi afatgjatë deri në fund të vitit 2009.

## Digjitalizimi

Procesi i digjitalizimit është një zhvillim që po ndodh në të gjithë Evropën. Çaku është që deri në vitin 2012 të kalohet në transmetime digjitale në vendet e Unionit Evropian. Poashtu, të gjitha vendet e regjionit kanë filluar procesin e digjitalizimit me qëllim të kalimit deri në vitin 2015. Kosova në këtë aspekt është mbrapa dhe ende nuk ka filluar të punoj në këtë drejtim. Kosova poashtu nuk ka qenë pjesë e konferencës së ITU-së Gjeneva 2006 ku janë dhënë alokimet e frekuencave për transmetim digjital në territorin e Evropës dhe kështu është dëmtuar nga ky proces.

Për të lehtësuar diskutimin rreth fillimit të procesit të digjitalizimit KPM-ja kishte ftuar tre ekspertë nga regjioni, të cilët kanë përvojë me funksionimin e ITU-së si dhe kanë qenë të lidhur ngushtë me procesin e digjitalizimit në vendet e tyre. Këta ekspertë ishin Stanko Perpar nga Sllovenia, Zoran Stefanovski nga Maqedonia dhe Elton Poga nga Shqipëria.

Punën e ditës së dytë e hapi znj. Grazhdani duke i falenderuar ekspertët për kohën e tyre dhe për ndihmën në krijimin e strategjisë së digjitalizimit në Kosovë. Ajo theksoi se duhet mësuar nga përvojat e regjionit. Znj. Grazhdani poashtu falenderoi përfaqësuesit e IREX-it, AMPEK-ut dhe KTTN-së për pjesëmarrjen dhe ndihmën e tyre.

## Roli i ITU-së dhe Rregullatorit në planifikimin e frekuencave digjitale – Stanko Perpar

Prezentimi i parë ishte mbi rolin e ITU-së dhe rregullatorit në planifikimin e frekuencave digjitale i prezentuar nga z. Perpar, përfaqësues i Sllovenisë në ITU.

ITU-ja është agjencioni i Kombeve të Bashkuara që merret me teknologjinë informative dhe komunikimin dhe është pika fokale për qeveritë dhe sektorin privat. Roli i ITU-së shtrihet në tre sektorë bazë: radiokomunikimet, standardizimi dhe zhvillimi.

Struktura e Unionit përbëhet nga Konferenca Plenare, e cila është organi suprem i ITU-së. Këshilli i cili është një nivel më poshtë dhe është përgjegjës për përgaditjen e konferencave. Më pas vijnë konferencat botërore mbi telekomunikimet ndërkombëtare. ITU-ja përmban poashtu Sektorin e Radiokomunikimeve, Sektorin për Standardizimin e Telekomunikimeve, Sektorin për Zhvillimin e Telekomunikimeve dhe Sekretariatin e përgjithshëm. ITU-ja është një organizëm ndër-qeveritar i cili në përbërjen e saj ka shtetet anëtare dhe anëtarët sektorial (përfaqësuesit e industrisë).

ITU-ja nxjerr mandatin e saj nga Kushtetuta e vet dhe ka përgjegjësi për alokimin e spektrit frekuencor dhe është përgjegjëse për regjistrimin e përcaktimeve frekuencore, pozitive orbitale dhe parametrave të tjerë, ashtu që të mund të shmangen interferencat e dëmshme në mes të stacioneve nga vendet e ndryshme. ITU-ja ndan

botën në katër regjione në të cilat menaxhon spektrin frekuencor, i cili konsiderohet si resurs natyror me kapacitet të limituar. Z. Perpar pastaj prezantoi funksionimin e organeve të ndryshme të ITU-së dhe procedurat për përcaktimin e brezeve frekuencore dhe regjistrimin e përcaktimeve në regjistrin e saj.

Prezentimi vazhdoi me paraqitjen e procesit të planifikimit të transmetimit digjital tokësor, ku z. Perpar u fokusua në parametrat teknike të përcaktimeve të fuqisë dhe pozitive të nevojshme për transmetim. Pastaj u fokusua në hapsirën e mbulesës së sinjalit. Duke bërë krahasimin me transmetimet analoge, ku edhe një mbulesë më e dobët mund të jetë e shikueshme, tek transmetimet digjitale mbulesa duhet të jetë shumë e mirë përndryshe do të ketë pengesa dhe bllokim të fotografisë, ku psh një rënie prej 3 dB në kualitetin e emitimit tek transmetimi digjital do të thotë mungesë të fotografisë.

Prezentimi pastaj u fokusua në dallimet e procesit të planifikimit digjital prej atij analog. Tek transmetimet digjitale, sipas z. Perpar, kemi efektin e rrëpimave, ku sinjali humbet shpejtë me një rënie të vogël të fuqisë transmetuese. Në anën tjetër kemi efikasitetin në përdorimin e frekuencave, me më shumë kanale për një frekuencë. Poashtu, transmetimi digjital nuk ballafaqohet me problemin e reflektimeve. Mundësia e Rrjetave në një frekuencë dhe pranimi edhe në pajisje të lëvizshme janë edhe disa përparësi të sistemit digjital.

Z. Perpar prezantoi disa nga vendimet e marra nga ITU-ja në konferencën Gjeneva 2006, ku u vendos mbi planin frekuencor për transmetim tokësor digjital në Fushat III, IV dhe V. Ky plan duhet të hyjë në fuqi në kohën kur shymben transmetimet analoge. Para se të ndodhë kjo, është planifikuar një periudhë e transmetimit simultan, ku transmetimi digjital është i kufizuar për shkak të kanaleve të mbrojtura analoge. Mirëpo, pas 17 qershorit 2015, me përjashtim të disa vendeve, transmetimet analoge nuk do të mbrohen më nga ITU-ja. Bashkimi Evropian ka propozuar që kalimi në transmetim digjital të kryhet deri në vitin 2012.

Z. Perpar pastaj prezantoi procedurat që duhen ndjekur nga vendet e ndryshme për modifikimin e planeve dhe koordinimin e shërbimeve primare terestriale. Administrata e cila propozon ndryshimin e planit frekuencor duhet së pari të marrë pajtimin e administratave të tjera të cilat mund të ndikohen nga ndryshimet. Po që se ekziston pajtimi, atëhere informohet ITU-ja dhe regjistrohen frekuencat e reja.

Në fund, z. Perpar paraqiti propozimet e tij për të shpejtuar periudhën e tranzicionit në transmetime digjitale. Së pari, pikat e planifikuara transmetuese duhet të mundësojnë pranimin portabël nga pajisjet e ndryshme, ashtu që të rritet mbulesa në kohën sa më të shkurtë të mundshme. Transmetuesit duhet të punojnë në shtimin e numrit të programeve që emetohen me sistemin digjital si dhe të nxiten shërbimet e reja transmetuese. Rregullatorët, sipas z. Perpar, fillimisht nuk duhet të ngrakojnë me taksa

për transmetim digjital si dhe të mos ofrojnë alokimin e frekuencave analoge për shërbime të reja në treg. Qeveria mund të ndihmojë duke ndihmuar në koston e pranuesve (bokseve digjitale) për popullatën. Së fundi, të gjithë akterët duhet të kyçen në një kampanjë të gjerë informimi mbi përparësitë e televizionit tokësor digjital.

Dy gjëra që sipas z. Perpar duhet që rregullatori të ketë parasysh janë standardi i transmetimit, gjegjësisht zgjedhja në mes të MPEG2 dhe MPEG4, ku dallimi është në kualitet dhe kosto. Ende nuk ekziston një standard i unifikuar në Bashkimin Evropian mbi këtë. Poashtu, rregullatori duhet të ketë kujdes që të informojnë njerëzit mbi pajisjet të cilat duhet blerë për pranim digjital, gjegjësisht cili model është konform standardeve të transmetimit në Kosovë.

### **Perspektiva dhe përvoja e Maqedonisë – Zoran Stefanovski**

Maqedonia qysh tani ka hyrë në procesin e digjitalizimit dhe ka bërë hapat e parë administrativë. Sipas z. Stefanovski, kryetar i Këshillit të Transmetimit të Maqedonisë, përvojat në Maqedoni janë shumë të ngjajshme me Kosovën. Si problem fillestar i identifikuar atje ishte mungesa e ekspertëve në këtë fushë. Maqedonia ka përdorur ndihmën me misionit të OSBE-së në Maqedoni për të shfrytëzuar përvojën e ekspertëve të huaj në rregullimin e tregut, legjislacionin e nevojshëm në bazë të standardeve të BE-së, për të nxitur diskutimin publik dhe së fundi për të aprovuar ligjin mbi digjitalizimin në vitin 2007.

Sipas z. Stefanovski, Maqedonia mori 8 alokime frekencash në UHF dhe 1 në VHF nga konferenca në Gjenevë. Kjo sipas tij i jep mundësi Maqedonisë të ofrojë rreth 80 kanale për televizione me transmetim standard digjital. Plani i Maqedonisë është që deri në vitin 2012 të kalojë në transmetim digjital, por sipas z. Stefanovski është më e mundur që ky afat të shtyhet për në vitin 2015.

Problemet me të cilat u ballafaqua Maqedonia në këtë proces ishin të shumta. Së pari, dhënia e pakontrolluar e frekuencave ka qenë një problem i madh. Poashtu ekzistojnë shumë probleme të mbledhjen e taksës për radiodifuzion. Problemet politike me zgjedhjet në Maqedoni poashtu e kanë ngadalsuar procesin.

Maqedonia ka shpallë tender ndërkombëtar për operator të tre multiplekseve ashtu që të nxisë investime të huaja dhe për momentin po punohet në nxjerrjen edhe të një multipleksi. Licencat e operatorëve janë të parapara të jenë me të drejtë shfrytëzimi për 10 vjet me mundësi të shtyerjes edhe për 10. Multipleksi i katër është i paraparë të shfrytëzohet nga televizioni kombëtar MTV. Operatorët janë të obliguar të furnizojnë popullatën me dekoder (set top box) me çmim të ulët. Vlerësohet se në Maqedoni ekzistojnë rreth 500,000 njësi shtëpiake. Subvencionin në Maqedoni nuk është i lejuar me ligj, prandaj është zgjedhur rruga e furnizimit përmes operatorëve. Sa i përket standardit të emetimit, Maqedonia ka zgjedhur kodimin MPEG4, i cili është më kualitativ por edhe më i shtrenjtë.

Edhe pse ekziston dokumenti i strategjisë për digjitalizim, ky dokument në Maqedoni nuk është finalizuar dhe është një dokument në përpunim të vazhdueshëm. Për realizimin e strategjisë së digjitalizimit, sipas z. Stefanovski, u krijua një trup i përbashkët i përbërë nga Agjencioni për Radiodifuzion dhe Agjencioni për Komunikime Elektronike. Ky trup është përgjegjës për të gjithë procesin e digjitalizimit dhe caktimin e standardeve teknike për pajisjet. Këto standarde janë plotësisht të definuara.

Sipas z. Stefanovski, digjitalizimi do të bëhet në dy faza. Së pari do të operacionalizohen multiplekset kombëtare e në fazën e dytë edhe multiplekset regjionale. Sipas tij, ky është një proces i gjatë dhe duhet të shkohet hap pas hapi, duke përfshirë gjatë gjithë kohës të gjithë aketrët. Ky proces do të rregullojë jo vetëm transmetimet tokësore por edhe ato satelitore nga Maqedonia.

Në pyetjen se cili model i transmetimit do të aplikohet në Maqedoni, z. Stefanovski tha se rregullatori do të caktojë që 1/3 e programeve të jenë kanalet kombëtare në Maqedoni, ndërsa 2/3 do të jenë stacione komerciale, jo vetëm nga Maqedonia. Poashtu ligji nuk lejon që operatori të jetë njëkohësisht edhe transmetues i programeve.

### **Perspektiva dhe përvoja e Sllovenisë – Stanko Perpar**

Prezentimi i përvojës nga Sllovenia filloi me paraqitjen e bazës ligjore për procesin e digjitalizimit. Sipas z. Perpar, kjo është rregulluar përmes Ligjit për mediat masive, Strategjisë për tranzicionin nga transmetimi analog në digjital, Ligjit mbi RTV Sllovenia dhe Ligjit mbi transmetimet digjitale. Strategjia ka paraparë që implementimi të bëhet në tre faza, dhe ate përgaditja e bazës për tranzicion 1 vit, faza e tranzicionit 4 vite dhe faza e kalimit ekskluziv në transmetim digjital që pason fazën e dytë nga viti 2011.

Sipas z. Perpar, Sllovenia është ndarë në tre regjione (3 alokime), secila nga to me nga tetë alokime. Fillimisht janë paraparë dy multiplekse. Multipleksi A do të bart programin kombëtar të televizionit publik slloven dhe programet regjionale. Multipleksi B i është dedikuar programeve komerciale.

Sa i përket kostos së pajisjes për transmetim digjital për një multipleks, sipas z. Perpar, kjo përfshin 4 milion euro për transmetuesit dhe mbushësit e zbrastirave, 2 milion euro për linqet, gjysmë milioni për koderët si dhe shpenzimet e tjera që vlerësohen rreth 1.5 milion euro. Kjo e bën koston e një multipleksi diku rreth 8 milion euro.

Në Slloveni jepen dy lloj licencash, njëra për transmetuesit dhe tjetra për multiplekset. Licenca për multipleksin B është vënë në tender dhe implementimi do të shkojë në dy faza. Faza e parë do të mbulojë rreth 50% të popullatës, ndërsa faza e dytë synon të mbulojë 70% të popullatës deri në qershor të vitit 2010.

Sipas z. Perpar, multipleksi që bart radio-televizionin publik nuk duhet të ketë përmbajtje komerciale, mirëpo në anën tjetër përmbajtja komerciale është një ndihmesë për të shtyer popullatën drejt kalimit në sistemin digjital. Në Slloveni, futja e programit



komercial TV3, i cili transmetonte ndeshjet e kampionatit Evropian, në multipleksin A së bashku me RTV Slloveninë ka shtyer shumë shikues të kalojnë në sistemin digjital të pranimit.

Çështja e fundit që z. Perpar ngriti në prezentimin e tij ishte ajo e radiove digjitale. Ai theksoi se në Slloveni sistemi ka transmetuar për më shumë se pesë vite, mirëpo në Slloveni ende ka më shumë transmetues se sa pranues për radio digjitale. Si problem shtesë në këtë drejtim janë sistemet e ndryshme që përdoren në vende të ndryshme si dhe mungesa e një standardi të përafërt ndërkombëtar. Sipas z. Perpar, radio digjitale do të jetë në rënie, mirëpo përsëri është vështirë të thuhet se cili sistem do të dalë fitimtar dhe do të mbijetojë.

### **Perspektiva dhe përvoja e Shqipërisë – Elton Poga**

Z. Poga filloi prezentimin e tij me theksimin e përparësive të sistemit digjital të transmetimeve. Sipas tij, ky sistem ofron cilësi maksimale, ofron kursim të spektrit radiofrekuencor ndërsa në të njëjtën kohë ofron mundësinë për një numri të madh kanalesh të vendosura në një frekuencë. Poashtu, ky sistem ofron mundësinë për interaktivitet mes shikuesit dhe ofruesit të përmbajtjes si dhe mundësinë për aplikacione të ndryshme softuerike. Sipas tij, transmetimi digjital ofron mundësinë e transmetimit të 12 programeve në një frekuencë, për dallim nga 1 program në sistemin analog. Poashtu, sistemi digjital mundëson mbulimin e një zone të caktuar me vetëm një frekuencë, përmes sistemit *Single Frequency Network (SFN)*, derisa me sistemin analog do të duheshin disa frekuenca.

Natyra e transmetimit poashtu ndërron rrënjësisht. Sipas z. Poga, derisa në sistemin analog, transmetuesi ka licencën për të transmetuar program, të cilin shpesh e prodhon vetë, si dhe ka përgjegjësinë për të ndërtuar rrjetin e transmetimit të këtij programi, në sistemin digjital paraqiten tre akterë të ndryshëm. Së pari kemi ofruesit e përmbajtjes, gjegjësisht programit. Pastaj kemi ofruesit e rrjetit të transmetimit. Përfundimisht kemi ofruesit e shërbimit, gjegjësisht operatorët. Sipas z. Poga kjo mundëson transformimin e shikuesit nga një rol tradicionalisht pasiv në një përdorues aktiv të shërbimit, i cili mund të ofrohet në mënyrë të personalizuar. Kjo sipas tij do të jetë edhe një shtytje e madhe për zhvillimin e tregut mediatik.

Përvoja në Shqipëri ka qenë pak më ndryshe. Në kohën kur rregullatori po punonte për të filluar procesin e digjitalizimit, një operator privat kishte filluar transmetimet digjitale qysh më herët. Sipas z. Poga, ka qenë vështirë të gjendet kuadri ligjor për ta futur këtë transmetues, i cili qysh më herët kishte monopolizuar tregun. Ligji për transmetime digjitale u aprovua në Shqipëri në vitin 2007 dhe ky ligj iu bashkangjiti ligjit për transmetime analoge dhe mundëson legalizimin e transmetimeve digjitale. Nëse nuk ekziston baza ligjore e cila rregullon këtë treg është e pamundur që të ndalen investimet dhe veprimtaria e operatorëve privat. Për këtë shkak, në Shqipëri rregullatori i

ka shkuar zhvillimit nga pas e jo duke e përgaditur procesin prej më parë, gjë që është problematike.

Në Shqipëri tashmë ka filluar edhe transmetimi digjital me sistemin DVB-H për pajisje mobile dhe ky po funksionon shumë mirë. Shqipëria, sipas z. Poga, është vetëm vendi i tretë në botë që ka aplikuar këtë teknologji.

Z. Poga pastaj prezantoi analizën e tij mbi pozitën e Kosovës nga marrëveshja e Gjenevës 2006. Pasi që Kosova në këtë proces u përfaqësua nga Serbia, pasi që nuk ishte anëtare e ITU-së, Serbia caktoi karakteristikat teknike dhe kanalet e rezervuara për Kosovën. Aty u caktua që i tërë territori i Kosovës të jetë një zonë shërbimi dhe janë regjistruar vetëm dy caktime frekuencore në ITU. Gjithsej Kosovës i janë rezervuar 10 frekuenca, 7 në bandën UHF dhe 1 në atë VHF si dhe 2 blloqe frekuencash në VHF për shërbimin T-DAB.

Koha e tranzicionit në sistemin digjital është paraparë të përfundojë më 2015 dhe pas qershorit të këtij viti frekuencat më parë të mbrojtura me marrëveshjen Stokholm 61 nuk do të mbrohen më. Prandaj, sipas z. Poga, kanalet analoge që transmetojnë në Kosovë nuk do të jenë të mbrojtura dhe do të mund të ndikohen nga interferencat e dëmshme nga vendet e tjera.

Sipas z. Poga, autoriteti rregullator duhet të krijojë kushte dhe infrastrukturën e përshtatshme teknike dhe ligjore me qëllim të fillimit të fazës eksperimentale dhe inkuadrimin të kësaj teknologjie. Ai poashtu rekomandoi që KPM-ja të bëjë planin e caktimeve frekuencore (rillogaritjen e SFN) duke pasur parasysh nevojat konkrete për platformat digjitale në Kosovë. Krijimi i infrastrukturës ligjore dhe teknike do t'i bëjë të mundur investimet dhe funksionimin normal të shërbimeve digjitale. Zbatimi i rekomandimeve dhe standardeve ndërkombëtare do të mundësonte shfrytëzimin më të mirë të brezit frekuencor, që është një resurs i kufizuar.

Rruga e anëtarësimit të Kosovës në ITU do të jetë e gjatë. Në ndërkohë zhvillimet nuk mund të presin zgjidhjen e kësaj çështjeje. Z. Poga rekomandoi që KPM-ja të shfrytëzojë planin ekzistues deri sa të hyj në procesin e autorizimit ndërkombëtar. Sipas tij, plani i dakorduar për Kosovën në marrëveshjen e Gjenevës nuk i ofron kushtet maksimale Kosovës, prandaj KPM-ja duhet të bëjë planin frekuencor dhe ta ndajë Kosovën sipas nevojës, duke ndjekur standardet ndërkombëtare, dhe pastaj me kohë të bëjë edhe notifikimin mbi këtë pranë ITU-së.

## **Procesi i digjitalizimit në Kosovë**

Qëllimi i diskutimit të kësaj seance ishte identifikimi i hapave të parë që duhet ndërmarrë në Kosovë për të nisur procesin e digjitalizimit. Ky proces është i mbushur me sfida dhe do të jetë një proces i gjatë, mirëpo qëllimi është të krijohet një plan që më si miri i përshtatet nevojave dhe kushteve të Kosovës. Takimi ka për qëllim të fillojë këtë

proces. Znj. Grazhdani sugjeroi se pa marrë parasysh kufizimet me të cilat ballafaqohemi, si psh mos anëtarësimi në ITU, ne duhet të planifikojmë thujse këto kufizime nuk ekzistojnë dhe të zgjedhim mënyrën më të mirë për zhvillimin e këtij sektori në të ardhmen.

Për ta shtyer procesin përpara duhet krijuar dhe adoptuar politikën për procesin e digjitalizimit. Kjo politikë duhet të adoptohet edhe nga shoqëria. Një proces i tillë fillon me konsultime dhe shkon deri në strategji dhe legjislacion.

Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan se për një proces të tillë është shumë e rëndësishme të involvohen të gjitha palët me interes në proces. Mirëpo, duhet të kemi kujdes që KPM-ja të jetë udhëheqësi i këtij procesi. Prandaj, palët me interes duhet të kyçen pasi të jetë identifikuar qasja ndaj këtij procesi. Grupi identifikoi listën e palëve me interes që duhet të përfshihen në proces, si vijon:

- AMPEK
- KOSMA
- KTTN
- Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave
- Ministria e Kulturës (të drejtat autoriale)
- ART
- Komisioni Parlamentar për Media
- Komisioni Parlamentar për Transport dhe Telekomunikacione
- Operatorët kabllor
- Shoqata për mbrojtjen e konsumatorit
- Fakulteti Ekektroteknik i Universitetit të Prishtinës
- Përfaqësuesit e bizneseve që do të merren me prodhimin/importimin dhe shitjen e pajisjeve

Pas palëve me interes diskutimi u fokusua në disa nga problemet me të cilat ballafaqohet Kosova në procesin e digjitalizimit. Problemi I parë është I natyrës ligjore, pasi Kosova nuk është anëtare e ITU-së dhe ajo nuk ka qenë e përfshirë në zhvillimin e planit frekuencor Gjeneva 06, i cili si i tillë nuk i përshtatet nevojave të Kosovës. Problem tjetër është se mungojnë politikat për procesin e digjitalizimit, të cilat janë të pajtuara nga të gjitha palët në Kosovë. Poashtu mungon edhe kapaciteti teknik i stafit në kuptim të planifikimit të frekuencave digjitale dhe kryerjes së matjeve të nevojshme. U përmend edhe fakti se procesi i digjitalizimit fillimisht do t'ju shërbejë kanaleve kombëtare, derisa kanalet lokale mund të ballafaqohen me vështirësi.

### **Objetivat e procesit të digjitalizimit dhe veprimet e nevojshme**

Objekti i këtij procesi është *Kalimi i transmetimit në sistem digjital*. Për të arritur këtë duhen kryer një varg veprimesh dhe duhet përcjellë një proces gjithëpërfshirës. Z.

Jakubowicz propozoi që të krijohet një sekretariat brenda KPM-së që do ta përcjell këtë proces dhe që do të ketë për detyrë ta mbajë procesin në lëvizje.

Në bazë të kësaj u propozua që pasi të mblidhen palët me interes duhet të caktohen nëngrupet punuese. Këto grupe do të duhet të marrin iniciativën dhe në rast të nevojës për ekspertizë më të specializuar, duhet pasur parasysh edhe mundësinë e konsultimit me ekspertë të jashtëm të KPM-së. Poashtu u diskutua edhe nevoja për ndërrimin e pajisjeve dhe kush do të paguaj koston për to.

Grupi pastaj diskutoi edhe një plan veprimi për KPM-në në procesin e digjitalizimit. Veprimet me të cilat u pajtuan pjesëmarrësit në takim, si dhe afatet kohore, u caktuan si vijon:

Veprimi	Afati kohor
1. Krijimi i grupit punues në kuadër të KPM-së	Deri më 1 gusht 2008
2. Studimi i përvojave nga vendet e tjera	Deri më 3 nëntor 2008
3. Organizimi i një tryeze publike rreth pozitës së Kosovës ndaj ITU-së (me përfaqësim nga MTT, ART, ZKM, Komisioni për media)	Deri më 15 nëntor 2008
4. Draftimi i dokumentit me opsionet e mundshme dhe planin frekuencor në vija të trasha	Mbetet të përcaktohet
5. Takimi me palët me interes	Deri më 30 nëntor 2008
6. Caktimi i grupeve punuese mbi çështjet teknike, ligjore, financiare	Deri më 12 dhjetor 2008
7. Zhvillimi dhe aprovimi i strategjisë për digjitalizim	Deri më 1 qershor 2009

Sipas z. Poga, shteti duhet të jetë ai i cili duhet të kërkoj dhe nxitë iniciativën dhe se kjo ka rol të veçantë në krijimin e një sistemi të vetëqëndrueshëm.

### Konkluzionet nga seanca e digjitalizimit

Pas pezetimeve të përvojave nga ITU si dhe nga përfaqësuesit e mediave diskutimi u fokusua në identifikimin e palëve me interes si dhe sfidave e problemeve për Kosovën në procesin e digjitalizimit.

Grupi pastaj vazhdoi të diskutojë rreth objektivave që dëshirojmë t'i arrijmë dhe veprimeve të mundshme nga KPM-ja. Duhet theksuar se diskutimet e bëra në këtë forum janë shumë fillestare dhe mbetet që Këshilli dhe Zyra e KPM-së të shtyejnë procesin tutje.

## Përmbledhje ekzekutive

Më datat 21-24 korrik 2008, në Shkup u mbajt Takimi i parë i Këshillit e Stafit të KPM-së dhe ekspertëve mbi proceset e ri-licencimit dhe digjitalizimit të sektorit medial në Kosovë. Pjesëmarrës në takim ishin përfaqësuesit e KPM-së si dhe hisenikët e tjerë nga sektori mediatik. Diskutimi mbi strategjitë e këtyre proceseve ishte i ndarë në dy pjesë.

Pjesa e parë kishte për fokus procesin e ri-licencimit, gjegjësisht dhënies së licencave afatgjate për mediat Kosovare. Seanca filloi me prezentimin e situatës momentale të ambientit rregullativ të mediave në Kosovë. Më pas, përfaqësuesit e KPM-së paraqitën skenare të mundshme për procesin e ri-licencimit si dhe përparësitë dhe mangësitë e këtyre skenareve. Procesi i ri-licencimit u ri-emërua në procesin e *Licencimit afatgjatë të mediave*. Gjatë diskutimeve u arrit pajtueshmëria e pjesëmarrësve rreth principeve të këtij procesi, objektivat e procesit si dhe veprimet që KPM duhet të ndër marrë për realizimin e tij që janë si vijon:

Principet:

- Procesi duhet të jetë në përputhshmëri me planin frekuencor të Kosovës
- Procesi duhet të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të sektorit medial në Kosovë
- Procesi duhet të krijojë mundësi për përmbushjen e nevojave të të gjitha komuniteteve për qasje në media në gjuhën e tyre
- Procesi duhet të kontribuojë në zbatimin e politikave të transmetimit të përcaktuara në Ligjin mbi KPM-në

Objetivat e procesit të licencimit afatgjatë janë si vijon:

**Objektivi 1:** Lëshimi i licencave afatgjate për mediat përmes klasifikimit të transmetuesve në tre kategori (automatiksht, me kushte, ritenderim) në bazë të përputhjes me legjislacionin dhe kushtet e kontratave të përkohshme (varet nga ligjshmëria) si dhe lëshimi i licencave afatgjate për transmetuesit e rinj.

**Objektivi 2:** Përcaktimi i kriterëve (kërkesave) të njehta për të gjitha mediat, duke përfshi kriteret në vijim: Teknike; të drejtat autoriale; financiare (qëndrueshmëria financiare); programore dhe qartësimi i pronësisë dhe strukturave menaxhuese.

**Objektivi 3:** Standardizimi i procedurave dhe dokumentacionit për licencim.

**Objektivi 4:** Krijimi i planit për distribuimin e frekuencave (përfshirë edhe periudhën pas digjitalizimit) dhe përcaktimi i pikave transmetuese

**Objektivi 5:** Krijimi i mundësisë për një transmetues publik kombëtar në gjuhët e pakicave

Veprimet që KPM-ja duhet të ndërmerret në muajt e ardhshëm janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

VEPRIMI	AFATI KOHOR	PËRGJEGJËSI
1. Kriteret për kategorizimin e mediave	15 gusht 2008	KPM
2. Krijimi i profileve për mediat aktuale	30 tetor 2008	KPM
3. Përcaktimi i kriterëve për licencim	15 nëntor 2008	KPM
4. Plani i distribuimit të frekuencave	30 tetor 2008	KPM
5. Standardizimi i dokumentacionit dhe procedurave	30 dhjetor 2008	KPM
6. Shpallja e konkursit (njoftimi)	15 shkurt 2009	KPM
7. Shqyrtimi i aplikacioneve dhe lëshimi i licencave	Grupi 1 (automatikisht) – 30 mars 2009	KPM
	Grupi 2 (me kusht) – 30 qershor 2008	
	Grupi 3 (ritenderim) – 31 dhjetor 2009	

Pjesa e dytë e takimit u fokusua në procesin e digjitalizimit të transmetimit medial në Kosovë. Për këtë diskutim, takimit iu bashkangjitën edhe përfaqësues të mediave Kosovare, transmetuesve që këto media shfrytëzojnë, përfaqësues të IREX-it si organizatë përkrahëse të mediave Kosoavre si dhe një numër ekspertësh të cilët ndanë me grupin përvojat nga procesi i digjitalizimit. Tre prezentues nga Sllovenia, Maqedonia dhe Shqipëria paraqitën përvojat dhe proceset e digjitalizimit të ndjekura në vendet e tyre.

Diskutimi rreth procesit të digjitalizimit në Kosovë kishte për qëllim propozimin e një plani veprimi për KPM-në, që në partneritet me palët e tjera me interes në këtë proces, të shtyjë procesin e digjitalizimit përpara. Plani i veprimeve të KPM-së është si vijon:

Veprimi	Afati kohor
1. Krijimi i grupit punues në kuadër të KPM-së	Deri më 1 gusht 2008
2. Studimi i përvojave nga vendet e tjera	Deri më 3 nëntor 2008
3. Organizimi i një tryeze publike rreth pozitës së Kosovës ndaj ITU-së (me përfaqësim nga MTT, ART, ZKM, Komisioni për media)	Deri më 15 nëntor 2008
4. Draftimi i dokumentit me opcionet e mundshme dhe planin frekuencor në vija të trasha	Mbetet të përcaktohet
5. Takimi me palët me interes	Deri më 30 nëntor 2008
6. Caktimi i grupeve punuese mbi çështjet teknike, ligjore, financiare	Deri më 12 dhjetor 2008
7. Zhvillimi dhe aprovimi i strategjisë për digjitalizim	Deri më 1 qershor 2009

## **Aneksi 1 – Agjenda e takimit**

### **AGJENDA E TAKIMIT TË PARË TË PËRBASHKËT E KËSHILLIT TË KPM-së, PERSONELIT TË LARTË TË ZYRËS DHE EKSPERTËVE NË LIDHJE ME STRATEGJINË PËR RILICENCIM DHE DIGJITALIZIM**

22 korrik 2008, e martë

#### **RILICENCIMI – Sfidë apo Lehtësim**

09:00 Prezantim nga Kryetarja e Këshillit të KPM-së, znj. Grazhdani

09:15 Prezantim i Zyrës për situatën aktuale në sektorin medial

Naile Krasniqi, Shefe Ekzekutive, dhe Besim Govori, Udhëheqës I Divizionit për Menaxhim të Frekuencave

- *Pyetje dhe përgjigje*

10:00 Prezantim për propozimin e Zyrës për procesin e lëshimit të

licencave afatgjate nga Naile Krasniqi, Shefe Ekzekutive

11:15 Pushim për kafe

11:30 Plani i ri-licencimit (Kur dhe për sa kohë) –Këshilli i KPM-së

13:00 Dreka

14:30 Planet për strategjinë e zhvillimit të këtij procesi:

- Dokumentacionet;
- Kategorizimi;
- Afatet kohore;

16:00 Pushim për kafe

16:15 Veprimet e KPM-së (Këshilli)

17:00 Konkluzione dhe rekomandime

17:30 Mbyllja e takimit të ditës së parë



23 korrik 2008

## Digjitalizimi

### Cila do të jetë e ardhmja Digjitale e Transmetimeve Televizive në Kosovë

- 09:00 Hyrja nga Kryetarja e Këshillit të KPM-së, znj. Grazhdani
- 09:10 Roli i ITU dhe i rregullatorit të transmetimit në planifikimet frekuencore kombëtare (informatë e përgjithshme) z. Stanko Perpar (nga RTV Sllovenia)
- *Diskutim i hapur (pyetje dhe përgjigje)*
- 10:30 Perspektiva dhe eksperiencia e Maqedonisë (strategjia dhe baza ligjore) / Prezantim nga Zoran Stefanovski (Kryetar i Këshillit të Transmetimit në Maqedoni)
- *Diskutim i hapur (pyetje dhe përgjigje)*
- 11:15 Pauza për kafe
- 11:30 Perspektiva dhe eksperiencia e Sllovenisë (strategjia dhe baza ligjore) / Prezantim nga z. Stanko Perpar
- *Diskutim i hapur (pyetje dhe përgjigje)*
- 12:15 Perspektiva dhe eksperiencia e Shqipërisë (strategjia dhe baza ligjore) / Prezantim nga z. Elton Poga
- *Diskutim i hapur (pyetje dhe përgjigje)*
- 13:00 Dreka
- 14:30 Prezantim nga përfaqësuesit e sektorit të mediave kosovare elektronike dhe nga Rrjeti Kosovar për Telekomunikacion Tokësor
- *Diskutim i hapur (pyetje dhe përgjigje)*
- 16:00 Pazuë për kafe
- 16:15 Diskutim për veprimet e KPM në procesin e:
- ngritjes së çështjes me institucionet përgjegjëse kosovare për inicimin e komunikimit me ITU

## KPM – Raport nga takimi mbi Strategjitë mbi ri-licencimin dhe digjitalizimin

- inicimit të diskutimeve publike me subjektet transmetuese dhe grupet tjera të interesit për të ardhmën e transmetimeve digjitale
- krijimit të grupeve punuese (ligjore, teknike, të licencimit dhe të implementimit) për planifikimet strategjike në lidhje me fazën e kalimit në digjital (hartimin e strategjisë)

17:00 Konkluzionet

17:45 Mbyllja e takimit nga Kryetarja e Këshillit të KPM-së

## **Aneksi 2 - Lista e pjesemarrësve**

### **Këshilli i KPM-së**

1. Argjentina Grazhdani, Kryetare
2. Adil Pireva, Anëtar
3. Daut Demaku, Anëtar
4. Filloreta Bytyqi, Anëtare
5. Karol Jakubowicz, Anëtar

### **Zyra e Shefit Ekzekutiv**

1. Naile Selimaj Krasniqi, Shefe Ekzekutive
2. Fikrete Çoçaj, Zyrtare për Marrëdhënie me Publikun
3. Besim Govori, Udhëheqës i Divizionit të Menaxhimit Frekuencor
4. Besim Rexhepi, Zyrtar i Lartë Teknik
5. Sefer Arifi, Zyrtar i Lartë Ligjor
6. Niman Racaj, Asistent Ligjor
7. Luan Latifi, Udhëheqës i Divizionit të Licencimit
8. Nuredin Islami, Zyrtar i Lartë i Licencimit
9. Teuta Zubaku, Udhëheqëse e Divizionit të Monitorimit
10. Mirand Tafarshiku, Zëvendës Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit
11. Amra Zejneli, Zyrtare për Monitorim
12. Agron Avdija, Zyrtar për Monitorim
13. Faruk Rexhaj, Zyrtar për Monitorim
14. Gentiana Çavdarbasha, Zyrtare për Monitorim

### **OSCE**

1. Samra Campara, Këshilltare e Lartë e KPM-së

### **Ekspertët/Prezantuesit**

1. Stanko Perpar, nga Sllovenia
2. Zoran Stefanovski, nga Maqedonia
3. Elton Poga, nga Shqipëria

### **AMPEK**

1. Ardita Zejnullahu, Drejtoreshë Ekzekutive

### **RKTI**

1. Arta Fetiu, Drejtoreshë Ekzekutive

### **IREX**

1. Andrew Clayton, Udhëheqës i Zyrës
2. Driton Qeriqi, Këshilltar Ligjor për Media

### **USAID**

1. Albana Kusari

### **Moderator**

1. Bersant Disha